




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, kk.rks-gov.net/gjilan, info.gjilan@rks-gov.net tel. 0280 320 781, 0280 320 782, 321 482, 321 483

Në bazë të nenit 12 pika c) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen e Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28, datë 4 qershor 2008) dhe në zbatim të nenit 40 të Ligjit mbi Tregtinë e Brendshme nr. 2004/18 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 17, datë 01 tetor 2007), Ligjit nr. 04/L-005 për Ndryshimet dhe Plotësimet nr. 2004/18 për Tregtinë e Brendshme (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 5, datë 21 korrik 2011), Kuvendi i Komunës së Gjilanit në mbledhjen e mbajtur me datën **27.06.2013**, miraton:

V E N D I M

PËR APROVIMIN E RREGULLORES PËR FILLIMIN DHE MBARIMIN E ORARIT TË PUNËS TË SUBJEKTEVE AFARISTE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË GJILANIT

- I. Me këtë vendim aprovohet Rregullorja për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës të subjekteve afariste në territorin e Komunës së Gjilanit.
- II. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Rregullorja për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës të subjekteve afariste në territorin e Komunës së Gjilanit, e hartuar nga Komisioni për akte normative i KK-Gjilan.
- III. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, pushon të vlej Rregullorja fillimin dhe mbarimin e orarit të punës të subjekteve afariste në territorin e Komunës së Gjilanit, nr.01.Nr.3261/0101 e datës 07.04.2008.
- IV. Zbatimin e këtij vendimi e bënë Drejtoria për Inspeksion dhe Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, ndërsa për implementimin e tij kujdeset Kryesuesi i KK-Gjilan
- V. Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhën zyrtare në web faqen e Komunës.

Nr.01. 16-59035
Gjilan, më 27.06.2013

Kuvendi i Komunës,

Izmi Zeka, Kryesues